

DOKUMENTACIONI

Procedura për ndryshimin e furnizuesit

Kërkesë për lidhje kontrate për furnizimin me energji elektrike

1. Kërkesë për ndryshimin e furnizuesit (e firmosur,vulosur) në dy kopje e cila do të paraqitet në mënyrë direkte, pranë selive të furnizuesit aktual ose nëpërmjet postës. Furnizuesi ka detyrimin ta bëj publik formatin e aplikimit dhe ti sigurojë klientit në cdo rast një te tillë pa pagesë.

Formati duhet të përfshij:

- Të dhënat e shoqërisë tregtare/personit fizik/juridik, selinë/adresën,NUIS/ID), emrin dhe mbiemrin si dhe të dhënat e klientit kërkues .
- Numrin identifikues të pikës së shpërndarjes siç paraqitet në bazen e të dhënave të operatorit.
- Datën e dorëzimit të aplikimit.
- Emri i shoqërisë tregtare të furnizuesit aktual dhe afatin e perfundimit të kontratës me furnizuesin e mëparshëm.

Procedura e ndryshimit të furnizuesit nuk mund të tejkalojë afatin 15 ditor, afat i cili fillon nga data e dorëzimit të aplikimit. Me pranimin e kërkesës për ndryshimin e furnizuesit nga furnizuesi aktual klienti nënshkruan kontratën e furnizimit me energji elektrike.

2. Vërtetimi i detyrimeve. Sipas Rregullores për ndryshimin e furnizuesit e miratuar nga ERE përcakton:
 - Çdo klient i energjisë elektrike që ka likujduar të gjitha detyrimet në raport me furnizuesin e parë.
 - Çdo klient debitor ndaj furnizuesit të mëparshëm, me kushte që debia të merret përsipër nga furnizuesi i mëparshëm sipas një marrëveshje të lidhur nga palët për likuidim të vonuar të debisë.